

STATUTI
I
SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR
“AKPL” sh.p.k

Në këtë Statut

- Ligji është Ligji Nr. 9901 datë. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”,
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë
- “Kontrata Koncesionare” është kontrata koncensionare me objekt “Projektimin, Ndërtimin, Operimin, Mirëmbajtjen, Rehabilitimin dhe Transferimin e Segmentit Rrugor Kashar - Pezë – Lekaj”.

KREU 1
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit/Ortakët

(1.1)

Sot, më **02.08.2024 (dymijë e njëzetë e katër)** në Tiranë, Shqipëri në zbatim të Ligjit nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, dhe Njoftimit të fituesit datë 03.02.2023 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë publikuar në Buletinin Nr 14, datë 13.02.2023 për “Projektimin, Ndërtimin, Operimin, Mirëmbajtjen, Rehabilitimin dhe Transferimin e Segmentit Rrugor Kashar - Pezë – Lekaj”, ne themeluesit, themelojmë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “AKPL” sh.p.k.

(1.2)

Themeluesit e shoqërisë / Ortaket e saj janë:

1. Shoqëria “Gjoka Konstruksion” sh.a, me seli në adresën Rruga “Dora D’Istria”, Hyrja 1 & 2, Tiranë, Shqipëri, me numër NIPT J91815014U përfaqësuar nga administratori i shoqërisë z. Rrok Gjoka.
2. Shoqëria “JUNIK” sh.p.k, me seli në Smt, Ndërtesë 2 katëshe, Kati 2, Pranë Drejtorisë Shërbimit Pyjor Lezhë me numër NIPT J68007522L, përfaqësuar nga administratori i shoqërisë z. Ded Malutaj.
3. Shoqëria “COBIAL” sh.p.k, me seli në adresë Rruga 'Milto Tutulani', Ndërtesa Nr.2, H. 19, Ne Zonen Kadastrale Nr.8270, me Nr. Pasurie 5/336N16, me numër NIPT K02715414M, përfaqësuar nga Administratori i shoqërisë z.Qemal Pazaj.
4. Shoqëria “PEPA GROUP” sh.p.k, me adresë Autostrada Tiranë Durrës Km 6, Zona Kadastrale Nr.2105, Nr Pasurie 1168/13, me numër NIPT L42215009L përfaqësuar nga Administratori i shoqërisë Violeta Pepaj.
5. Shoqëria “UDHA” sh.p.k, me seli në Lagjia “Pjeter Budi”, me numër NIPT K77524909Q përfaqësuar nga Administratori i shoqërisë z.Arben Çela.



6. Shoqëria "A & E ENGINEERING" sh.p.k, me seli ne Rruga "Mujo Ulqinaku", Objekti Nr.23, Z.1, Tiranë, Shqipëri, me numër NIPT K72113010E, përfaqësuar nga administratori i shoqërisë zj.Entela Çano.
7. Shoqëria "GEOPORTAL" d.o.o, degë e shoqërisë së huaj, me seli ne rrugën "Dora D'Istria", N. 1, 1019, Tiranë, Shqipëri, me numër NIPT L62115002A, përfaqësuar nga Përfaqësuesi Ligjor i shoqërisë z. Andrej Likar.

(1.3)

Ortakët gëzojnë përgjegjësi të kufizuar deri në limitin e kontributit përkatës në kapitalin e Shoqërisë të përfaqësuar në Kuota.

Neni 2

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

2.1 Shoqëria "AKPL" sh.p.k do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi, këtë Statut si dhe Kontratën e Koncesionit me objekt "Projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen, rehabilitimin dhe transferimin e segmentit rrugor Kashar-Pezë-Lakaj ("Kontrata e Koncesionit"), e cila do të nënshkruhet ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkimit të Përkohëshëm të Shoqërive (Ortakët e Shoqërisë) të shpallur fituese në procedurën konkurruese sipas Formularit të Njoftimit të Fituesit datë 03.02.2023 lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë publikuar ne Buletinin Nr. 14, datë 13.02.2023 me qëllim **"Projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen, rehabilitimin dhe transferimin e segmentit rrugor Kashar-Pezë-Lakaj ("Kontrata e Koncesionit")**.

2.2 Objekti aktivitetit të Shoqërisë do të jetë zbatimi i Kontratës së Koncesionit të përmendur në pikën 2.1 më lart, përfshirë por pa u kufizuar në Projektimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen, në funksion të Koncesionit/partneritetit publik privat në zbatim të parashikimeve të Kontratës Koncesionare për këtë koncesion.

2.3 Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari të nevojshme e të dobishme, të lejuar nga ligji për realizimin e objektit të aktivitetit të saj.

2.4 Shoqëria ka të drejtë të ndryshoj objektin e veprimtarisë së saj në cdo kohë sic parashikohet në këtë Statut duke marr parasysh dispozitat e "Kontratës së Koncesionit"

Neni 3


Kohëzgjatja

Shoqëria e ushtron veprimtarinë e saj dhe vepron si person juridik me personalitet të plotë për të vepruar për një kohë të pacaktuar, dhe minimalisht për një kohë jo më të shkurtër se kohëzgjatja e Kontratës së Koncesionit objekt i aktivitetit të Shoqërisë.

Neni 4

Selia

(1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Dora D'Istria", Hyrja pasuria nr. 6, 7/637+1-B1,



Zona Kadastrale 8270, Volumi 78, faqe 151, Tiranë, Shqipëri.

(2) Shoqëria ka të drejtë të ndryshoj selinë e saj në një adresë dhe/ose në një qytet tjetër të Shqipërisë. Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi kudo brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

(3) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është: akpl_2024@yahoo.com

KREU II KAPITALI

Neni 5 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **1.000.000 (një milion) Lekë**. Kapitali shoqërisë do të shlyhet brenda 1 viti nga Ortakët, në proporcion me pjeset e tyre takuese në një llogari bankare që Shoqëria do të hapë në një nga bankat e Nivelit të Dytë në Republikën e Shqipërisë nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB.

Pjesëmarrja e themeluesve/ortakeve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me pjeset e tyre takuese.

Neni 6 Numri i pjesëve të kapitalit themeltar të nënshkruar

6.1 Numri i pjesëve të kapitalit themeltar të nënshkruar është 7 (shtatë), në raport me kontributin e dhënë nga çdo Ortak në Shoqëri.

6.2 Çdo Ortak zotëron një kuotë të vetme në Shoqëri.

Neni 7 Vlera nominale e secilës pjesë të kapitalit themeltar të nënshkruar dhe lloji i kontributit

7.1 Vlera nominale e secilës pjesë të kapitalit themeltar të nënshkruar është:

1. Një kuotë e zotëruar nga shoqëria "Gjoka Konstruksion" sh.a (J91815014U) që përbën 97.0% (nëntëdhjetë e shtatë pikë zero përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë, me vlerë 970,000 (nëntëqind e shtatëdhjetëmijë) Lekë.
2. Një kuotë e zotëruar nga shoqëria Shoqëria "JUNIK" sh.p.k, (J68007522L) që përbën 0.4% (zero pikë katër përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë, me vlerë 4,000 (katërmijë) Lekë.
3. Një kuotë e zotëruar nga shoqëria "COBIAL" (K02715414M) që përbën 0.9% (zero pikë nëntë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë, me vlerë 9,000 (nëntë mijë) Lekë.



STATUT I SHOQERISE "AKPL" SH.P.K

4. Një kuotë e zotëruar nga shoqëria "PEPA GROUP" sh.p.k (L42215009L) që përbën 0.3 % (zero pikë tre përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë, me vlerë 3,000 (tremijë) Lekë.
 5. Një kuotë e zotëruar nga shoqëria "UDHA" (K77524909Q) që përbën 0.3% (zero pikë tre përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë, me vlerë 3,000 (tremijë) Lekë .
 6. Një kuotë e zotëruar nga shoqëria "A & E ENGINEERING" (K72113010E) që përbën 1.078 % (një pikë zero shtatëdhjetë e tetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë, me vlerë 10,780 (dhjetëmijë e shtatëqind e tetëdhjetë) Lekë.
 7. Një kuotë e zotëruar nga shoqëria "GEOPORTAL" d.o.o, degë e shoqërisë së huaj, (L62115002A), që përbën 0.022% (zero pikë zero njetetë e dy përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë, me vlerë 220 (dyqind e njëzetë) Lekë .
- 7.2 Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të Luajtshme/të Paluajtshme apo të drejta).

Neni 8

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, në rast të mosdakordësismit me marrëveshje ndërmjet ortakëve atëherë palët mund ti drejtohen Gjykatës kompetente për emërimin e një eksperti të autorizuar për vlerësimin e kontributeve në natyrë.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin e shoqërisë mbi vlerën e përcaktuar në dokumentacionin shoqëruar të kontratës koncensionare "Projektimi, Ndertimi, Operimi, Mirëmbajtja, Rehabilitimi dhe Transferimi i Segmentit Rrugor Kashar-Pezë-Lakaj", që do të lidhet me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas Njoftimit të Fituesit date 03.02.2023.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.


Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 9

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.



STATUT I SHOQERISE "AKPL" SH.P.K

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe nëstatut dhe në kontratën e koncesionit "Projektimi, Ndertimi, Operimi, Mirëmbajtja, Rehabilitimi dhe Transferimi i Segmentit Rrugor Kashar-Pezë-Lakaj", që do të lidhet me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas Njoftimit të Fituesit datë 03.02.2023

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Në rast të tjetërsimit të kuotës së kapitalit nga ana e Ortakut të shoqërisë, Ortakët e tjerë të shoqërisë kanë të drejtën e parablerjes së saj. Radha e parablerjes së kuotës nis nga Ortaku i cili ka kontributin më të madh në kapitalin e shoqërisë. Procedura e njoftimit të transferimit të kuotës nga Ortaku i cili ka vendosur të tjetërsojë kuotën e tij, do të jetë nëpërmjet një njoftimi zyrtar paraprak drejtuar Ortakëve sipas rradhës së kontributit në kapitalin e shoqërisë, duke i lënë një afat 15 ditë pune për t'ju përgjigjur thirrjes së tij. Oferta duhet mbi kuotën së do të tjetërsohet duhet të përmbajë çmimin e kërkuar për të dhe periudhën kohore brenda së cilës oferta është e vlefshme, në mënyrë që Ortakët e tjerë të ushtrojnë të drejtën e blerjes apo ta refuzojnë atë. Në rast se Ortaku me kontributin më të madh në kapitalin e shoqërisë nuk shpreh interes për blerjen e kuotës, e drejta e parablerjes i kalon Ortakut tjetër në rradhë. Afati kohor për procedurat e negociimit për tjetërsimin e kuotës së Ortakut do të jetë jo me shumë se 60 ditë.

Neni 10

Anulimi i kuotes dhe Procedurat e saj

Në rast se Ortakët brenda afatit kohor të caktuar në këtë statut nuk kryejnë shlyerjen e kuotës në numrin e llogarisë bankare të shoqërisë, atëherë shoqëria mund të marrë vendim për anulimin e kuotës së shlyer me $\frac{3}{4}$ e ortakëve të shoqërisë që kanë shlyer kontributin fillestar dhe rishpërndarjen e % të secilit ortak në raport me kontributin total të shlyer nga ortakët. Vendimi do t'i drejtohet QKB për regjistrim, duke kryer rregullimin përkatës në regjistrin tregtar, sipas % përkatëse të mbetura, pas anulimit të kuotës.

Në përfundim të afatit të caktuar për shlyerjen e kuotës, Asambleja e thirrur në përputhje me afatet e njoftimit të mbledhjes, do të marrë vendim sipas shumicës së përcaktuar më sipër, vendim i cili do t'i komunikohet Ortakëve të shoqërisë në adresat zyrtare të komunikimit, sipas adresave zyrtare të regjistruara në QKB. Gjithashtu një kopje e vendimit do të dërgohet edhe Ortakut, kuota e të cilit është anuluar, në adresën zyrtare të tij.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 11

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton cdo

ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per cheshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqerisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) cheshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e pergjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqerisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakeve në asamblenë e pergjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së pergjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 12

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e pergjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë dhe sipas ketij statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakeve, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e pergjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 13

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e pergjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorunit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 14 **Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasyqruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 15 **Përfshirja nga drejta e votës**

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
 - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.



Neni 16
Administrimi

- (1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 4 (katër) vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- (2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- (3) **Personi i mëposhtëm** caktohet si Administrator i parë dhe i vetëm i shoqërisë deri në datë **02.08.2028**.

Të dhënat e identifikimit:

dhe specimenët e nënshkrimit:

Emer Mbiemer,

Elvis Gjoka, i biri i Rrok-ut,
i datëlindjes 19.11.1979, lindur në Fierzë, Pukë.

(emer mbiemer adrese): _____

Neni 17
Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.



Administratoret jane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Kur Asambleja e Përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 18

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
ç) të parandalojë dhe mënjanë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori/it, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse,

veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
 - a) u kthen ortakëve kontributet;
 - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV VITI FINANCIAR - EKSPERTËT

Neni 19 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor 2024.

Neni 20 Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë të ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar për të raportuar me shkrim për



nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

KREU V PRISHJA – RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 21 Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqerise mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në cdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emëtesën shtesë "Shoqeri ne likuidim e siper".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueuse, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 22 Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 23 Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqërite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 24
Mosmarrëveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 25
Regjistrimi i Shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit

Autorizohet administratori i shoqërise z. Elvis Gjoka dhe /ose ne mungese te tij shoqëria "Gjoka Konstruksion" sh.a, dhe cdo person i ngarkuar prej saj, shoqerise "Gjoka Konstruksion" sh.a me autorizim të thjeshtë që të bëjë regjistrimin e shoqërisë në QKB nepermjet portalit qeveritar e-Albania.

ORTAKET
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "AKPL" SH.P.K

Shoqëria "Gjoka Konstruksion sh.a
Administratori z.Rrok Gjoka




Shoqëria "JUNIK" sh.p.k
Administratori z. Ded Malutaj




Shoqëria "COBIAL" sh.p.k

Administratori z.Qemal Pazaj




Shoqëria "PEPA GROUP" sh.p.k

Administratori zj.Violeta Pepaj



Shoqëria " UDHA" sh.p.k

Administratori z.Arben Çela



Shoqëria "A & E EN GINE RING" sh.p.k

Administratori zj .Entela Gano



Shoqëria "GEOPORTAL" d.o.o, degë e shoqërisë së huaj

Përfaqësuesi Ligjor z. Andrej Likar.

Signature of Andrej Likar and text: ANDREJ LIKAR